



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 10 Prot

Datë, 11.03.2020

VENDIM

Nr.4, datë 11.03.2020

PËR

HAPJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR REKTOR DHE ANËTAR TË SENATIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORË

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në zbatim të nenit 2, pika g, nenit 18, pika 2, të Vendimit të Senatit Akademik Nr.59, datë 11.02.2020 "Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë; Urdhërit nr. 135, datë 09. 03. 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për mbylljen e institucioneve arsimore për parandalimin e përhapjes së Covid-2019", Urdhërit nr. 135, datë 09. 03. 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Urdhërit nr. 91, datë 09. 03. 2020 të Ministres së MASR "Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jo publike", Urdhërit nr. 20, datë 09. 03.2020 dhe Urdhërit nr. 21, datë 10. 03. 2020 të Rektorit, në funksion të mbarëvajtjes së procesit zgjedhor institucional, në kushtet e zbatimit të masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit nga COVID-19; Vendimit të Komisionit Institucional Zgjedhor Nr.1, datë 11. 03. 2020 "Për kryerjen e detyrave funksionale të Komisionit Institucional Zgjedhor përmes komunikimit telefonik dhe elektronik", Komisioni Institucional Zgjedhor,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Rektor dhe Anëtar të Senatit Akademik në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.
2. Të miratojë periudhën kohore të regjistrimit të kandidatëve datën 24.03.2020, deri në datën 28.03.2020, brenda orarit zyrtar 8:00-16:00.
3. Procesi i regjistrimit kryhet kur kandidati paraqitet personalisht në zyrën e Komisionit Institucional Zgjedhor për të depozituar dokumentacionin për kandidim. Pas regjistrimit, kandidati i jepet vërtetimi i regjistrimit si kandidat nga Komisioni Institucional Zgjedhor.
4. Vendimi afishohet në të gjitha mjediset e universitetit, si dhe publikohet në faqen web www.univlora.edu.al.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar i Komisionit Institucional Zgjedhor
Oljana Hoxhaj**

**Anëtarët
Shkelqim Sinanaj
Eljona Zanaj
Evis Allushi
Kristi Mucollari**